

15  
113/

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil  
Administrim Publik

Shkolla e Lartë Universitare, Jopublike, "Universiteti "Marin Barleti""

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Merita Xhumari



Prof. Asoc. Dr. Enri Hide



(Janar/2019)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti""
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 96, datë 27.01.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 329, datë 07.08.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional Shkenca Politike me profile: Administrim Publik
6	Cikli i studimit:	Cikli I Dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit/2 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Nr i studenteve	37 studentë

## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik**

Fakulteti i Shkencave Humane, me degët psikologji, shkenca politike dhe sociologji, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 27.01.2009 "Për hapjen programeve të studimit të ciklit të dytë në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti", hapi programin e studimit Master i Nivelit të Parë (MNP) me drejtim Administrim Publik, i cili aktualisht zhvillohet në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, Departamenti i Shkencave Politike. Ky program studimi është akredituar për herë të parë me Urdhër të MASR Nr. 329 datë 07.08.2012 për një periudhë 6 vjeçare (2012-2018) si "Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik". Programi është i organizuar në lëndë mësimore dhe ka 60 ECTS dhe konfirmohet me shkresën e Rektorit të SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" drejtuar ASCAL me datë 26.03.2018 "Për mënyrën e organizimit të programeve të studimit sipas departamenteve në UMB". Pas kërkesës së grupit të punës gjatë vizitës në institucion, na u vu në dispozicion edhe shkresa me datë 17.12.2017 e Dekanes së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike drejtuar Rektorit dhe Administratorit të SHLUJ UMB, ku paraqiten ide mbi studimin e tregut të punës ku rezultoi se drejtimi Administrim Publik dhe Politika Publike janë nga më të kërkuarat nga studentët, fakt që justifikon nevojën e akreditimit të këtij programi Masteri Profesional në Shkenca Politike me drejtim Administrim Publik.

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Asoc. Dr. Merita Xhumari dhe Prof. Asoc. Dr. Enri Hide ekspertët të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Me datë 13.12.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 24.12.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

**Për Komentin e parë, GVJ** merr në konsideratë shpjegimin e institucionit dhe rivlerëson rekomandimin referuar dokumenteve shtesë të paraqitura nga SHLUJ UMB.

**Për Komentin e dytë,** GVJ merr në konsideratë pjesërisht shpjegimin e institucionit, pasi rekomandimi lidhet me trajnime të rregullta dhe periodike të stafit pedagogjik, duke ia lënë gjithsesi këtë diskrecionit dhe nevojës së institucionit, jo trajnime sporadike apo *ad hoc*. Për pikën 2 të Komentit dhe shpjegimit të institucionit, mirëkuptohet shpjegimi i institucionit.

Lidhur me komentet e institucionit dhe reflektimin e RVJ-së mbi këto komente, janë bërë ndryshimet e nevojshme edhe në tekstin e mëposhtëm të raportit.

# ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

## I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a. Në të ardhmen të shihet nga UMB mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë sepse kjo gjë do ta ndihmonte atë të plotësonte standardet lidhur me numrin e pedagogëve me kohë të plotë e të krijonte një profil të plotë të sajën (aktualisht 55% e pedagogëve janë me kohë të plotë për programin Master Profesional Shkenca Politike me profil Administrim Publik, pra nuk e plotëson këtë standard; problem nga i cili vuajnë shumica dërrmuese e universiteteve private në Shqipëri);
- b. Për Master Profesional Shkenca Politike me profil Administrim Publik, të shihet mundësia që në semestrin e dytë të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore;
- c. Të bëhet shumë promovim për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushën e administrimit publik;
- d. Të pasurohet biblioteka me libra të autorëve të njohur të vendit dhe të huaj dhe të bëhen abonime në libraritë elektronike të universiteteve të njohura të huaja.
- e. Duhet vënë theksi në përmirësimin dhe azhurnimin e vazhdueshëm të programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe të huaj.
- f. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

### Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin për rritjen e numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë, në programin e studimit raporti i pedagogëve me kohë të plotë është rritur nga 55% në 88%, ku është angazhuar vetëm një pedagog me kohë të pjesshme. Pedagogët si PAE në këtë program studimi kanë gradën shkencore Doktor, përveç një pedagogu i cili është doktorant në proces.

### Rekomandimi është plotësuar

- b) Për rekomandimin dy, në semestrin e dytë të studimeve Master Profesional **nuk ka të përfshira të paktën dy lëndë me zgjedhje**. Nga takimet në institucion me drejtuesit e institucionit dhe departamentin kjo argumentohet me Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", ku lëndët me zgjedhje nuk janë më të detyrueshme, ndonëse ky Vendim hyn në fuqi për vitin 2018 që nuk përbën objekt të këtij vlerësimi.

### Rekomandimi nuk është plotësuar

- c) Për rekomandimin mbi rritjen e mesatares në hyrje të studentëve të regjistruar, kjo ka ardhur në rritje nga viti në vit, sikurse edhe numri i studentëve deri në vitin akademik 2015-2016, pastaj ka një tendencë rënije të numrit, ndonëse mesatarja mbetet e pacënuar.

### Rekomandimi është plotësuar

- d) Për rekomandimin e pasurimit të bibliotekës me literaturë vendase dhe të huaj, me propozime librash nga çdo pedagog i departamentit, çdo vit është akorduar një fond i veçantë për blerje librash. Sipas propozimeve të pedagogëve të departamentit të Shkencave Politike që do t'i shërbejnë edhe këtij programi studimi.

### Rekomandimi është plotësuar

- e) Për rekomandimin e përmirësimit dhe azhurnimit të programit duke u bazuar në literaturën më bashkëkohore të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi na evidentoi sesi ata kanë modifikuar silabuset konform kërkesave të ligjit të ri të arsimit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare në kuadrin e projekteve Jean Monet, etj. Stafi akademik i departamentit gjatë takimit në institucion konfirmoi se ka rishikuar syllabuset e lëndëve dhe literaturat

e programit në masën e lejuar nga ligji, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen me praktikën dhe modelet bashkëkohore të ndjekura nga universitetet perëndimore si dhe objektivat strategjike të institucionit.

**Rekomandimi është plotësuar**

- f) Për rekomandimin e dhënies së gjuhës së huaj të studentëve të këtij programi, që prej vitit akademik 2016-2017, në respekt të ligjit të ri të arsimit të lartë, kriteri i njohjes së gjuhës së huaj për këtë nivel studimi nuk përbën kriter përjashtues.

**Rekomandimi është plotësuar**



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është ndërtuar në përputhje me qëllimin e institucionit për të ofruar programe studimi sipas nevojave të kohës dhe për t'iu përgjigjur aspiratave për një shoqëri të zhvilluar e të integruar në strukturat evropiane, duke i dhënë rëndësinë që i takon administrimit publik. Objektivat e mësimdhënies janë promovimi i studimeve krahasuese, shumëdisiplinore në fushat e të drejtës administrative, politikës, qeverisjes, administrimit publik, sociologjisë, psikologjisë dhe edukimit me synimin për të përgatitur specialistë me koncepte moderne të menaxhimit publik dhe të mirëqeverisjes së sektorit publik. Në qendër të aktivitetit të SHLUJ UMB janë studentët dhe në këtë program studimi duket se angazhimi i tyre në tërë veprimtaritë brenda dhe jashtë auditorit është i konsiderueshëm, sikurse del edhe nga biseda direkte me studentët e diplomuar në vite në këtë program studimi.

Objektivat akademike dhe shkencore të mirëpërcaktuara sipas strukturave përgjegjëse të këtij institucioni janë në përputhje të plotë me kërkesat për modernizimin e mësimdhënies në arsimin e lartë, duke u përshtatur me kërkesat e legjislacionit shqiptar në ndryshim, sikurse Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimet e MASR dhe të ASCAL, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, etj.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është ndërtuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit për të ofruar programe studimi sipas nevojave të kohës dhe për t'iu përgjigjur aspiratave për një shoqëri të zhvilluar e të integruar në strukturat evropiane, duke i dhënë rëndësinë që i takon administrimit publik. Ky mision është shpallur publikisht në ëbsite të institucionit dhe në dokumentet e vena në dispozicion për qëllimet e këtij vlerësimi. Përmes marrëdhënieve institucionale me administratën publike dhe studentëve të diplomuar, Departamenti ka arritur në përfundimin se studentët për programet e administrimit publik kanë shfaqur interes të lartë referuar shkresës me datë 17.12.2017 e Dekanes së Fakultetit drejtuar Rektorit dhe Administratorit të SHLUJ UMB, ku paraqiten ide nga studimi i tregut të punës nga ku rezulton se drejtimi Administrim Publik dhe Politika Publike janë nga më të kërkuarat nga studentët, fakt që justifikon nevojën e akreditimit të këtij programi Masteri Profesional në Shkenca Politike me drejtim Administrim Publik. Programi i studimit është hartuar duke marrë parasysh kërkesën akademike të studentëve që mbarojnë ciklin e parë të studimeve
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>në SHLUJ UMB.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e zhvillimit të qendrueshëm të qeverisjes publike dhe synimin për integrimin evropian. Kjo reflektohet në program ku përfshihen lëndë që trajtojnë çështjet dhe parimet e administratës publike shqiptare dhe të standardeve dhe qeverisjes evropiane. Vlerat më të mira të qeverisjes evropiane qendrojnë në themel edhe të vlerave kulturore të kombit shqiptar.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është ndërtuar mbi programin bachelor në shkenca politike, me synimin për të përgatitur specialistë me koncepte moderne të menaxhimit publik dhe të mirëqeverisjes së sektorit publik.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nga Udhëzimet e MASR dhe të ASCAL.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve të përshtatshme për të mundësuar njohuri të specializuara dhe praktikë profesionale në shkenca politike.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Informacioni i siguruar nga institucioni dhe takimet me drejtuesit dhe stafin akademik provojnë se SHLUJ UMB ka një Plan të Zhvillimit Strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve master.</p> <p>Përmirësimi i rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit përbën një nga objektivat e mësimdhënies që është në vemendjen e stafit akademik sikurse rezultoi gjatë takimeve në institucion dhe bisedave me studentët.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit që zotëron SHLUJ UMB, vizitës në institucion si dhe diskutimeve me drejtuesit, stafin dhe studentët e institucionit, rezulton se SHLUJ UMB ka një Plan të Zhvillimit Strategjik, ka përcaktuar vizionin dhe misionin, të cilët janë reflektuar qartë në programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik.</p> <p>Misioni i Masterit Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është i shprehur qartë në Rregulloren e Studimeve të këtij programi, i cili synon pajisjen me njohuri të thelluara teorike dhe praktike sipas nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Ky program është ndërtuar dhe ofruar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimet e MASR dhe të ASCAL.</p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Departamenti i Shkencave Politike ku zbatohet programi Masterit Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është pjesë përbërëse e Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike. Programi mësimor në këtë nivel studimi Master Profesional në Shkenca Politike mbështetet në përvojat e suksesshme të stafit akademik me gradën shkencore Doktor, të diplomuar në universitete perëndimore apo në Universitetin e Tiranës.

Departamenti i Shkencave Politike prezantohet me një program të plotë studimesh universitare në nivelet Bachelor dhe Master Profesional e Shkencor, ku synohet përgatitja e specialistëve për një karrierë të suksesshme në sektorin publik dhe atë privat, si specialistë të kualifikuar të administratës publike dhe agjencive të tjera qeveritare, institucioneve të pavarura, botës akademike apo organizatave jo qeveritare ku janë punësuar studentët e diplomuar në këtë degë.

Në zbatimin e programit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik, Departamenti i Shkenca Politike mbështetet nga Departamenti i Drejtësisë në fushat shkencore juridike si e drejta administrative. Në të njëjtën kohë Departamenti krijon marrëdhënie me Departamentet e tjerë të Fakultetit dhe me Institute ndëruniversitare siç është Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike me qëllim organizimin jo vetëm të veprimtarisë mësimore, por edhe kërkimore.

Secila njësi bazë ka koordinatorin për çdo fushë studimi i cili mban lidhjet me sekretarinë e Studimeve Master. Koordinatorin, në bashkëpunim me përgjegjësit e njësive bazë koordinon aktivitetet rreth organizimit, menaxhimit dhe zhvillimit të programeve master, rreth procesit të praktikës dhe të provës finale si dhe këshillon studentët në lidhje me studimet.

SHLUJ UMB ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet vakante të punës, që ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhënave, etj. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut për nivelet e larta të drejtimit (neni 28-30 i Statutit), ndërsa për stafin tjetër sipas nenit 23 të Statutit të UMB, është bordi që miraton kriteret kryesore arsimore për stafin që rekrutohet. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit vakant nga strukturat përkatëse (eprori i drejtpërdrejtë).

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga tre departamente:

- 1) Departamenti i Shkencave Politike,
- 2) Departamenti i Drejtësisë dhe
- 3) Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.

Objektivat akademike të ndara sipas departamenteve përgjegjëse të këtij fakulteti janë në përputhje të plotë me kërkesat për modernizimin e mësimdhënies në arsimin e lartë, duke ruajtur specifikat në fushën e shkencave politike të pasqyruara në programet e studimit në nivelet Bachelor dhe Master Profesional e Shkencor. Struktura aktuale i përgjigjet përbushjes së misionit pasi ajo është e plotësuar me institute si Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike dhe Instituti i Edukimit Barleti. Në mbështetje të këtyre strukturave, institucioni ka krijuar edhe rrjetin e vet të bashkëpunimit akademik e kërkimor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke qenë pjesë e disa projekteve që lehtësojnë bashkëpunimin akademik dhe shkëmbimet e studentëve.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, programit, syllabuseve, CV të stafit akademik dhe pas bisedës me ta gjatë vizitës në institucion, u arrit në konkluzionin se stafi akademik i Departamentit të Shkencave Politike i angazhuar në programin Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik ka kompetencat për të zhvilluar kurrikulën e konceptuar sipas standardeve bashkëkohore dhe t'u japë studentëve koncepte dhe



njohuri bazë në disiplinat themelore që studiojnë sot politikën dhe administrimin publik. Stafit akademik i Departamentit të Shkencave Politike ka edhe përvojë pune në administratën publike që mundëson lidhjen e teorisë me praktikën si dhe praktikën e studentëve.

Bazuar në të dhënat që na ka venë në dispozicion institucioni, stafi akademik i Departamentit të Shkencave Politike për vitin akademik 2012-2013 dhe 2013-2014 ka pasur 6 pedagogë PAE dhe po aq PAK, nga të cilët 4 kanë pasur gradën shkencore Dr dhe dy të tjerë me Master. Në vitin akademik 2014-2015 Institucioni ka reflektuar mbi rekomandimin për rritjen e stafit akademik të brendshëm efektiv të Departamentit dhe ka shtuar 2 të tjerë me titullin Prof.Assoc., si dhe marrje të këtij titulli nga dy profesorë ekzistues, duke e reduktuar në 3 numrin e PAK, të tre me gradën shkencore Doktor. Për vitin akademik 2015-2016, janë larguar dy Prof.Assoc të shtuar një vit më parë nga PAE, dhe është shtuar një me gradën shkencore Doktor duke arritur në 7 numri i PAE dhe një PAK, situatë e njëjtë edhe për vitin pasardhës akademik 2016-2017 dhe për vitin 2017-2018. Pas një përvoje në statusin e PAK, Sh. C. ka kaluar PAE në vitin akademik 2018-2019. Kjo dinamikë e stafit akademik tregon për qendrueshmëri, siguri dhe nivel të lartë akademik.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Shkresa me datë 17.12.2017 e Dekanes së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike drejtuar Rektorit dhe Administratorit të SHLUJ UMB mbi studimin e tregut të punës mbi drejtimin Administrim Publik dhe Politika Publike.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Institucioni organizohet sipas një strukture organizative që i shërben plotësisht të misionit të tij për ofrimin e programeve të studimit të ciklit të dytë Master Profesional.</p> <p>Në strukturën organizative të SHLU UMB bëjnë pjesë dy fakultete: 1) Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike dhe 2) Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.</p> <p>Çdo Fakultet organizohet në tre Departamente, konkretisht Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga: Departamenti i Shkencave Politike, Departamenti i Drejtësisë dhe Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.</p> <p>Njësitë bazë të këtyre fakulteteve kanë objektiva dhe mision të përcaktuar për organizimin, menaxhimin dhe zhvillimin e programeve Bachelor dhe Master. Ato propozojnë programet akademike dhe realizojnë zbatimin e tyre.</p> <p>Departamenti i Shkencave Politike që mbulon programin ka në përbërjen e tij 8 anëtarë efektivë, 5 prej tyre janë me gradën shkencore Doktor, një është duke e mbyllur në Dept. e Shkencave Politike të Universitetit të Tiranës.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti si njësi bazë rezulton e vetëdijshme për përgjegjësitë për realizimin e programeve të studimeve. Kjo rezulton nga mënyra e funksionimit të departamentit, i cili merr përsipër shpërndarjen e ngarkesës, formimin e kurrikulave, përmirësimin e tyre si dhe ka pjesë thelbësore në procesin e garantimit të cilësisë.</p> <p>Departamenti është pjesë integrale në procesin e</p>

	<p>rekrutimit të personelit akademik (gjatë identifikimit të nevojës për personel të ri dhe gjatë procesit të intervistimit).</p> <p>Gjatë takimeve të realizuara me në SHLUJ UMB, kuptuam se kërkesa në lidhje me nevojat për pedagogë niste nga Departamenti, i cili vendoste edhe kriteret që duhet të plotësonte kandidati. Më pas kërkesa kalonte në dekanat e për miratim në rektorat dhe ky i fundit e dërgonte kërkesën tek zyra e burimeve njerëzore. Zyra e burimeve njerëzore bënte shpalljen e vendeve vakante në faqen zyrtare të UMB. Në grupin e ngritur për rekrutimin e stafit kishte gjithmonë përfaqësues nga Departamenti.</p> <p>Për sa i përket vlerësimit të stafit, gjatë takimeve konstatoam se stafi akademik në fillim të çdo viti akademik bënte një parashikim paraprak të punës që do të realizonte, gjithashtu IAL për vlerësimin e performancës së personelit akademik organizonte në fund të çdo semestri, dy herë në vit pyetësorët e studentëve.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Nga të dhënat e dokumentacionit të vetëvlerësimit të institucionit dhe nga gjëndja e konstatuar gjatë vizitës në institucion për këta tregues arrihet në konkluzionin se organizimi i strukturave të SHLUJ UMB i shërben plotësisht të misionit të tij për ofrimin e programeve të studimit të ciklit të dytë Master Profesional.</p> <p>Në strukturën organizative të SHLU UMB bëjnë pjesë dy fakultete, çdo Fakultet organizohet në tre Departamente dhe Departamenti i Shkencave Politike që mbulon programin Master Profesional në Shkenca Politike ka në përbërjen e tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët 5 janë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Të dhënat për kualifikimin e Personelit akademik tregojnë se ai përmbush standardet e cilësisë pasi është me gradën shkencore Doktor, me përjashtim të y pedagogëve që janë në përfundim të studimeve doktorale. Fusha e kualifikimit përputhet me lëndët që ata zhvillojnë në këtë program Masteri Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik. Krahas personelit akademik efektiv (PAE) të Departamentit të Shkencave Politike, për lëndët juridike ofrohet staff akademik efektiv i Departamentit të Drejtësisë, apo për lëndët me drejtim ekonomik, angazhohet PAE nga Departamenti i Ekonomisë. Edhe një pedagog që në RVB është klasifikuar si Personel Akademik me Kontratë (Shpëtim Cani), në momentin e vizitës në institucion ai ishte emëruar PAE.

Raportet e personelit akademik me personelin administrative janë të kënaqshme, duhet theksuar se pothuajse i gjithë personeli akademik ishte i angazhuar me detyra administrative si Dekan i Fakultetit, Drejtues i Instituteve Kërkimore, Koordinator Programi, etj. Stafi administrativ është i organizuar në nivel institucioni në dy struktura: për programet bachelor dhe për programet master. Numri i vogël i studentëve i vendoste këta të fundit në pozita të privileguara në raportet një profesor për një student. Në këtë situatë nuk u konstatuan nevoja për personel akademik/ administrative shtesë. Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik varioante

nga 300-350 orë mësimore në auditor, krahas aktiviteteve të tjera jashtë kohës së mësimi.

Zyra e Burimeve Njerëzore ka përcaktuar qartë në modelin tip të kontratave të punës për personelin akademik shpërndarjen e ngarkesave sipas tre komponentëve: mësim në auditor, kërkim shkencor dhe veprimtari administrative. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut të UMB, është bordi që miraton kriteret kryesore dhe departamenti kriteret sipas lendëve për stafin që rekrutohet në varësi të vendit vakant. Zyra e Burimeve Njerëzore vuri në dispozicion dokumentacionin me kriteret e rekrutimit të personelit akademik dhe procedurat për zbatimin e tij

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat në Aneks)

Nga të dhënat e pasqyruara në RVB dhe dokumentacionin e depozituar në sistemin e të ASCAL, të verifikuara nga takimet me stafin akademik dhe administrativ në institucion, rezulton se SHLUJ UMB plotëson kriteret e organizimit të tre departamenteve me personel akademik efektiv mbi 7 pedagogë, nga të cilët mbi 3 kanë gradën shkencore DOKTOR. Nga vitet e para të akreditimit të parë 2012-2013 dhe 2013-2014 ku stafi i Departamentit të Shkencave Politike ka pasur 50% PAE (6 pedagogë) dhe 50% PAK (6 pedagogë) dhe në vitin akademik 2014-2015 ka ardhur në rritje nga 6 në 8 PAE duke reduktuar në 3 PAK duke arritur në tre vitet e fundit akademike 2015-2016, 2016-2017 dhe 2017-2018 të anagzohet vetëm 1 PAK. Kështu janë plotësuar edhe një nga rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm për rritjen e PAE. Kështu në vitet e fundit 2015-2016, 2016-2017 dhe 2017-2018 peshën më të madhe të mësimdhënies në program e mbulon PAE në masën 89% (7 nga 8 pedagogë) dhe vetëm një pedagog është me kontratë. Pesha mësimore e 37 krediteve mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë dhe pesha mësimore e 5 krediteve mbulohet nga stafi akademik me kohë të pjesshme. Pesha e krediteve të praktikës profesionale si edhe provës finale (provim formimi/ tezë për studentët me mesatare mbi 9.5), prej 18 ETCS mbulohet gjithashtu nga pedagogë të brendshëm.

Stafi akademik ndër vite është rritur jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi referuar gradave e titujve shkencorë të PAE të Departamentit të Shkencave Politike. Referuar stafit akademik të Departamentit që ofron këtë program Masteri Profesional ai përmbush kriterin që titullarët e lë endëve janë me gradën shkencore Doktor. Ka vetëm një PAE që vazhdon në proces doktorature nga viti 2012-2013 deri në vitin e fundit akademik të akreditimit 2017-2018.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Tabela në Aneks)

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit i programit të studimit kanë kualifikimin e duhur për këtë program studimi, dy nga të cilët me doktoraturë në universitetet jashtë vendit dhe me përvojë drejtimi në administratën publike.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat në Aneks)

Mbi bazën e verifikimit të dhënave të RVB dhe të dhënave gjatë vizitës në institucion mbi kualifikimin e stafit rezulton se të tre departamentet dhe veçanërisht ai që zbaton programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike përmbush kriteret pasi ka në përbërje 5 personel akademik efektivë me gradën shkencore Doktor dhe vetëm një personel akademik efektiv me Master, ndërsa PAK ka vetëm 1 me gradën shkencore Doktor, i cili në vitin aktual 2018-2019 është bërë personel akademik efektiv. Raporti PAE/PAK në tre vitet e fundit akademike 2015-2017 është 8/7 PAE me 1 PAK, ku vetëm 1 PAE është në proces doktorature dhe gjithë të tjerët me gradën shkencore Doktor.

- Të dhënat sipas gjinisë (Tabelat në Aneks)

Barazia gjinore është reflektuar në përbërjen e personelit akademik të Departamentit të Shkencave Politike, me një numër të barabartë 6 gra dhe 6 burra të përfshirë në vitin akademik 2012-2013. Ndërsa në vitet e mëvonshme ky raport ndryshon duke u zvogëluar numri i pedagogeve gra i cili reduktohet në 2 gra përgjatë periudhës 2014-2018.

- Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela në Aneks)

Të dhënat sipas moshës së personelit akademik efektiv tregojnë se dominon mosha 36-45 vjeç, moshë premtuese për avancimin e programeve mësimore dhe veprimtarisë shkencore.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Me kontratat e punës u njohem në detaje nga biseda në institucion me drejtuesen e burimeve njerëzore e cila na vuri në dispozicion kontratat model të personelit akademik efektiv dhe të personelit akademik me kontratë. Çdo anëtar i stafit akademik dhe administrativ nënshkruan në fillim të çdo viti akademik kontratën e punës me Rektorin, me përjashtim të rastit të evidentuar aty të kontratës së D. J. të cilit i kishte filluar kontrata në 02.02.2018, sepse në atë kohë i kishte mbaruar kontrata me projektin. Duke qënë juriste me doktoraturë, drejtuesja e burimeve njerëzore kishte formate kontratash në përputhje me Kodin e Punës, ku përcaktoheshin qartë të gjitha detyrimet dhe të drejtat e palëve. SHLUJ UMB po ashtu kishte të ndara qartë ngarkesat në mësimdhënie, në projekte kërkimore dhe në punë administrative në ndihmë të institucionit për çdo personel efektiv me kontratë., deri tek formatet për marrjen e lejes për interesa profesionale apo personale. Zyra e burimeve njerëzore ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit, ku pjesë e vlerësimit të stafit referuar kontratave të personelit janë disa aspekte: mësimdhënia, kërkimi dhe kontributi në projekte.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në vizitën dy ditore në institucion, bisedat me stafin ndihmës/ administrativ për Departamentin e Shkencave Politike na lanë mbresë në korrektësinë e dokumentacionit, kompetencën dhe njohjen e të gjithë situatës së programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike. Sekretaria mësimore na vuri në dispozicion rregjistrat e organizuar në përputhje me kërkesat e MASR dhe ASCAL. Zyra e Burimeve Njerëzore na vuri në dispozicion kontratat e punës, format vetëdeklarimit vjetor të ngarkesës së stafit akademik ku krahas ngarkesës mësimore pasqyrohej puna shkencore dhe veprimtaria në mbështetje të institucionit. Po ashtu u njohm me një formular aplikimi për leje; shpallje për vende vakante për staf akademik, të cilat tregojnë për një stafit ndihmës/ administrativ të përgjegjshëm dhe mbështetës.

- Dokumentacioni mbështetës për këtë fushë

Model kontrate pune; Vetëdeklarimi vjetor i ngarkesës; Formular aplikimi për leje; shpallje për vende vakante për staf akademik.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Nga takimet dhe dokumentacionet e paraqitura nga personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit gjykohet se ai angazhohet në përmbushjen e detyrave për realizimin e programit të studimit dhe për zhvillimin e institucionit sipas standardeve të cilësisë. Këto detyra janë të parashikuara në kontratë ose të dhëna sipas nevojave të institucionit.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Nga takimet me departamentin e Shkencave Politike, personeli akademik na shpjegoi se ai luan rolin kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimarrjen për organizimin e programit të Studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik. Pas propozimit për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave të
<b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi	

<p>i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>departamenteve ato kalohen për miratim në Senatën Akademik. Nga takimet me departamentin dhe me zyrën e Burimeve Njerëzore arrihet në gjykimin se rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa e stafit PAE varion në 300-350 orë mësimore në vit, duke dhënë nga tre lëndë në semestër.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Baza ligjore për rekrutimin e personelit përbëhet nga Ligji për Arsimin e Lartë, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS, Korniza rregullatore e UMB. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e UMB është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit. Kriteret shpallen publikisht në ëmbësitin e institucionit dhe kanale të tjera informacioni dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Peshën më të madhe mbi 70% (rreth 89%) të mësimdhënies në këtë program e mbulojnë stafi akademik me kohë të plotë 7 nga 8 pedagogë, ku vetëm një është me kontratë. Kuadri rregullator i SHLUJ UMB përmban procedura transparente të vlerësimit të personelit. Nga intervistat me studentët dhe stafin akademik del që vlerësimi bëhet si vertikalisht nga shefi i departamentit ashtu dhe nga studentët të cilët shprehen konsideratë për pedagogët, ndonëse tashmë ishin diplomuar. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e UMB ka një bazë të dhënash (dosje personale aplikimi dhe punësimi, tabela statistikore) për të gjithë personelin akademik të brendshëm dhe me kontratë.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Politike që zhvillon këtë program studimi ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore, Itali dhe përvojë akademike. Të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve në këtë program të studimeve “Master Profesional” kanë gradën shkencore “Doktor”, ndonëse kjo nuk është e detyrueshme dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi. Në Programin e studimit master profesional në Shkencë Politike me profil Administrim Publik japin mësim: 1 pedagog me titullin Profesor Doktor; 2 me titullin Prof. Asoc.; 4 me gradën Dr.; dhe 1 pedagog në proces doktorature me diplomë master i shkencave dhe eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies. Rektori ka një përvojë që nga akreditimi i parë, zv/rektori po ashtu vjen nga pozicioni i mëparshëm i përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Politike, njëkohësisht edhe dekane. Po ashtu përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve Master Profesional në Shkencë Politike. Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për</p>

mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale, në raportet një pedagog një student.
<b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IAL dhe nga takimet e realizua na u tha se për këtë program Masterit Profesional nuk aplikohet teze diplome por provim.
<b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	Për këtë program studim Masterit Profesional nuk aplikohet teze diplome por të gjithë studentët i nënshtrohen një provimi formimi.
<b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	SHLUJ UMB ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore, i cili u asiston si pedagogëve dhe studentëve dhe mirëmban gjithë rrjetin e internetit dhe pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës. SHLUJ UMB ka përcaktuar qartë në kontratat e punës çdo komponent të angazhimit profesional dhe administrativ të stafit akademik efektiv dhe me kontratë, krahas pozicioneve të ndryshme pune për shërbimet. Nga bisedat me personelin evidentohet një politikë e mirë për menaxhimin e burimeve njerëzore që janë plotësisht të angazhuar për të përmbushur objektivat e programit.
<b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program studimi Master Profesional prej 300-350 orësh në auditor është në ngjashmëri edhe me ngarkesën prej 150 orësh + 200 orë mbingarkesë të përcaktuar nga qeveria.</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në SHLUJ UMB disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>Krahas Zyrës së Burimeve Njerëzore, edhe Departamenti i Shkencave Politike, Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, Sekretaria Mësimore Master kanë informacion të plotë për personelin e angazhuar në realizimin e programit. Regjistrat pasqyrojnë saktë mësimdhënien dhe listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrative.</p> <p>Procedurat e rekrutimit pas verifikimit të dokumentacionit në zyrën e Burimeve Njerëzore rezultojnë transparente, të konfirmuara edhe nga takimi me stafin akademik efektiv.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të situatës gjatë vizitës në institucion përmes bisedave me personelin e angazhuar rezulton se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit janë të motivuar dhe të angazhuar në programin e studimeve Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik. Zyra e Burimeve Njerëzore në SHLUJ UMB disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>Stafi akademik mbulon mbi 70 përqind të programit të studimit dhe përmbush kriteret e gradës shkencore. Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program studimi Master Profesional prej 300-350 orësh në auditor është në përputhje me ngarkesën prej 150 orësh + 200 orë mbingarkesë të përcaktuar nga qeveria.</p> <p>Procedurat e rekrutimit pas verifikimit të dokumentacionit në zyrën e Burimeve Njerëzore rezultojnë transparente, të konfirmuara edhe nga takimi me stafin akademik efektiv.</p> <p>Në përputhje me Rregulloren akademike të SHLUJ UMB dhe në Rregulloren e Programit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik personeli akademik angazhohet dhe luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programit të studimit, në procesin e zbatimit të politikave të zhvillimit të institucionit, në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të përmirësimit të cilësisë.</p>	

**4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.




Nga të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit dhe pas vizitës dy ditore në të dy kampuset e SHLUJ UMB u evidentua se mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët përmbushin standardet që lidhen me këta tregues për zhvillimin me sukses të këtij program studimi. Referuar numrit të vogël të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi që nga fillimi i tij, sallat janë mjedise të përshtatshme, laboratorët me akses në internet dhe biblioteka gjithashtu në të dy kampuset e SHLUJ UMB. Mjediset sportive dhe degët e studimit të lidhura me sportin u japin mundësi të gjithë studentëve të zhvillojnë hobet e tyre në lidhje me sportin. Vendodhja e godinës qendrore pranë parkut të madh të liqenit artificial të Tiranës është atraktive si për gjithë qytetarët e Tiranës, edhe për studentët që ndjekin studimet në këtë institucion për aktivitete në natyrë dhe mjedise shplohëse.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Tabelat në Aneks)

Për realizimin e programeve të studimit SHLUJ UMB ka dy kampuse ku programi Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik përqëndrohet kryesisht në kampusin 2. Ky kampus ka një sipërfaqe të konsiderueshme përdorimi të destinuar për salla leksionesh dhe zyra për sekretarinë mësimore të Masterit dhe të pedagogëve. Në mbështetje të studentëve funksionojnë shërbimi i fotokopjeve, mensa, biblioteka, Zyra e Pranimit dhe Rregjistrimit, Dekani i Studentëve me shërbimet për vetorganizimin studentor, Zyrën e alumnit dhe Karrierës, Klinika e Këshillimit psiko-social dhe qendra sportive.

- Mjediset për stafin:

Mjediset për mësimdhënie janë të përshtatshme, referuar sallave të leksioneve e seminareve, sallës së internetit dhe aksesit në internet në të gjitha mjediset e universitetit. Fakti që stafi akademik efektiv i Departamentit të Shkencave Politike është rritur në sasi dhe cilësi është një tregues i një mjedisi stimulues për stafin sikurse edhe për studentët.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Vendodhja e godinës qendrore pranë parkut të madh të liqenit artificial të Tiranës është atraktive si për gjithë qytetarët e Tiranës, edhe për studentët që ndjekin studimet në këtë institucion. Ka dy kampuse, një mjedis qendror administrativ dhe një mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore e programit Master Profesional në Shkenca Politike.</p> <p>Mjediset janë pronë e aksionarëve të SHLUJ UMB. Programi i studimit zhvillohet në të dy kampuset, zyrat për stafin akademik, biblioteka, laborator informatik, sekretaria mësimore qendrore dhe stafi ndihmës administrativ, salla leksionesh dhe seminaresh janë kryesisht në kampusin 1, ku ndodhen edhe zyrat e Departamentit të Shkencave Politike.</p> <p>Kriteri 4 nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe biseda me bibliotekaren verifikuam që funksionon biblioteka online, biblioteka në intranet. Po ashtu, studentët ishin të familjarizuar me aksesin në literaturën bashkëkohore, në literaturën e ofruar nga pedagogët e këtij programi studimi dhe me</p>



programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

revistën shkencore "Gjeopolitika". Revista "Gjeopolitika" botohet periodikisht çdo gjashtë muaj dhe trajton çështje dhe problematika të lidhura me shkencat juridike, shkencat politike dhe ekonomike.

Nga takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit u konfirmua se ata vazhdimisht për vit porositin librat e duhura për procesin mësimor. Po ashtu, funksionon dhe UMB Press e cila ka mundësuar publikime të ndryshme.

Biblioteka ofron shërbim të kënaqshëm për studentët dhe qendron e hapur përgjatë orëve që zhvillohet programi i studimit.

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Gjatë vizitës në institucion konstatuam se për realizimin e programit të studimit ka një sasi të mjaftueshme klasash me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, laboratorë me PC për studentët si dhe pajisjet e nevojshme për stafin akademik dhe stafin ndihmës. Në kampusin numër dy ku edhe bëhet mësimi i programit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Studentët dhe stafi akademik u shprehën të kënaqur me mjediset ku zhvillohet veprimtaria mësimore të cilat janë të mjaftueshme për grupet e vogla me 10-15 studentë të këtij programi studimi.

Sa i takon Kriterit 4, Programi Master profesional në Shkenca Politike me profil: Administrim Publik nuk parashikon praktika laboratorike.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Nga të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit dhe pas vizitës dy ditore në të dy kampuset e SHLUJ UMB u evidentua se mjediset, infrastruktura, pajisjet e institucionit dhe vendodhja e tij ka hapësirat e nevojshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për programin e ciklit të dytë Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik.

Universiteti vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore sikurse u verifikua gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit.

Institucioni ka gjithashtu laboratorë informatike me akses pa limit në internet për studentët dhe stafin akademik, pajisje për prezantimet individuale dhe punë në grup. Institucioni ka vënë në dispozicion të programit Master profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik mjedise të përshtatshme dhe teknologji mësimore moderne.

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

SHLUJ UMB evidenton burime të ndryshme financimi ndër të cilat vendin kryesor e zenë të ardhurat nga studentët si burim kryesor në vite të financimit të kostove të këtij institucioni. Burime financimi janë gjithashtu konsulentat dhe shërbimet e trajnimit të ofruara nga stafi akademik i institucionit. Nëse në vitin 2012 pothuajse 100% e të ardhurave vinin nga tarifat studentore; në 2017 këto të ardhura janë gati dyfishuar për shkak të rritjes

së numrit të studentëve por ato përbejnë vetëm 93.4%, ndërkohë janë shtuar të ardhurat nga konsulencat, shërbimet dhe trajnimet në masën 5.5%. Po ashtu, janë shtuar si burim financimi të ardhurat nga qeratat dhe interesat bankare në masën 1.1% të të ardhurave të institucionit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim 0%
- Konsulencat, shërbimet 0%
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit 100%
- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Në vitin e fundit akademik 2016-2017 kostoja për student ka rezultuar 1150 Euro, referuar RVB. Pagesat e studentëve, pavarësisht oshilacioneve në numrin e tyre në këto 6 vite, kanë mbetur të pandryshuara dhe ato janë të krahasueshme me universitetet e tjera jopublike në vend.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Raporti i auditit të brendshëm paraqet pasqyrën e burimeve të financimit dhe të të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programeve të studimit në tërësi ku përfshihet edhe ky program i ciklit të dytë. Departamenti i Shkencave Politike ka siguruar të ardhura nga konsulenca dhe shërbime trajnimi, jo domosdoshërisht të lidhura me këtë program studimi, por që janë në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Zyra e Financës harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, etj. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, 2012-2017 ku rolin kryesor e ka luajtur numri i studentëve dhe të ardhurat prej tyre. Ky fakt provon se SHLUJ UMB ka kapacitete financiare të mjaftueshme dhe rritja e burimeve të financimit nga konsulencat dhe shërbimet tregon për përmirësimin e situatës financiare të të ardhurave në të ardhmen.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
SHLUJ UMB ka burime financimi të qëndrueshme, kryesisht nga të ardhurat e studentëve të pasqyruara në raporte financiare që na u vunë në dispozicion nga zyra e financës gjatë takimit në institucion.	

Ndonëse në RVB theksohet se “Burimet kryesore të të ardhurave janë kapitali financiar i Shoqërisë “Dudaj” pjesë e të cilës është SHLUJ UMB”, nga raportet financiare rezulton se të ardhurat e siguruar nga tarifa e shkollimit që paguajnë studentët dhe konsulentat dhe shërbimet e trajnimit janë burimet kryesore të financimit.

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucionalizimi i sistemit të brendshëm të cilësisë pranë Shkollës së Lartë Universitare JoPublike “Marin Barleti” është sanksionuar në maj të vitit 2018, me vendim të Rektorit, nr. 50 (dt. 07 Maj 2018). Përpara kësaj periudhe, me një vendim tjetër të Rektorit (Nr. 38, 2016) është ngritur dhe funksion në nivel institucioni Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (i përbërë nga 4 anëtarë) që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë në Senat. Përmes këtij vendimi, sistemi i garantimit të brendshëm të cilësisë është vendosur brenda të njëjtës strukturë me zhvillimin e kurrikulave – nëpërmjet themelimit të Zyrës së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Si një zyrë e re, ajo tenton t’i përgjigjet sigurimit të cilësisë përmes ndërtimit të procedurave të vlerësimit të brendshëm. Komponentë të vetëvlerësimit, në përgjegjësi të kësaj zyre janë grumbullimi dhe përpunimi periodik i të dhënave institucionale, zhvillimi dhe përpunimi i të dhënave nga sondazhet me studentët, si dhe bëra pjesë bashkë me mekanizmat e tjerë në proceset e vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe atij mbështetës. Kjo njësi është autonome dhe ka si detyrë gjithashtu të bashkëpunojë me departamentet për zhvillimin e kurrikulave. Në funksion të vlerësimit të cilësisë, zyra përgatit raporte periodike vjetore për Rektorin si dhe, mes një sërë funksionesh, ka dhe atë të koordinimit të procesit të vetëvlerësimit të njësisë akademike.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - o Sa anketime kanë bërë me studentët
  - o Sa studentë janë anketuar
  - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - o Etj

Kjo njësi kryen anketime periodike (dy herë në vit, ose çdo semestër) me secilin grup studentësh (dy javë përpara përfundimit të semestrit). Numri i studentëve që kryejnë anketimin nuk përputhet gjithmonë me numrin e plotë të studentëve që frekuentojnë një lëndë, për shkak se kryhet vetëm me ata që janë të pranishëm në momentin e kryerjes së tij. Por nga ana tjetër, për shkak të numrit të kufizuar të studentëve që frekuentojnë programin e studimit të marrë në shqyrtim, nevojitet që anketimet të përfshijnë numrin maksimal të studentëve të regjistruar, në mënyrë që të dhënat të bëhen sa më të vlefshme. Procesi i anketimit gjithsesi pasohet nga përpunimi i të dhënave që i bëhet me dije Rektorit, çdo PAE dhe PAK në mënyrë individuale si dhe studentëve, në funksion të përmirësimit të kurrikulave dhe mësimdhënies. GVJ konstatoi nga takimi me GVV se janë ndërmarrë masa konkrete në disa raste në funksion të përmirësimit të cilësisë. Kjo tablo plotësohet me vlerësimet e programit nga pedagogët e jashtëm. Një element tjetër i verifikuar edhe në RVV lidhet me projektet evropiane të sigurimit të cilësisë së brendshme ku është përfshirë SHLUJ UMB (Erasmus+ QAINAL), që në këndvështrimin tonë si GVJ shërben në planin afatmesëm dhe afatgjatë për të rritur kapacitetet dhe menaxhuar cilësinë e brendshme të institucionit.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë garantohet kryhet me disa hallka dhe në intervale vjetore nga ZZHKC (themeluar në 2018). Ndërkohë që pranë institucionit është ngritur që prej vitit 2016 Komisioni për Sigurimin e Cilësisë (i përbërë nga katër anëtarë) që i raporton drejtpërdrejt Senatit. Mbetet relativisht i paqartë raporti mes këtyre dy hallkave institucionale, kyçe për sigurimin e cilësisë, çka bën të nevojshëm një qartësi më të plotë të funksioneve të përbashkëta dhe dallimeve mes tyre.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Përgjegjësitë për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë janë shpërndarë në këtë mënyrë: Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (i përbërë nga 4 anëtarë – shih më lart); Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë; Rektori; Senati; Përgjegjësi i Departamentit.

Aktorja kryesore në sigurimin e cilësisë është zyra, ndër përgjegjësitë e së cilës radhiten: ndjekjen me vëmendje realizimin e procesit mësimor në përputhje me planet mësimore; mbajtjen e të gjithë dokumentacionit lidhur me programet mësimore, të dhënave mbi rezultatet e studentëve; kujdesen për hartimin e tabelës semestrale e vjetore të ngarkesave mësimore; organizimin e procesit të vetëvlerësimit nga njësitë akademike bazë; formulimin e mendimeve e propozimeve për plotësimin e standardeve të cilësisë në programet mësimore apo ato institucionale; etj.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga ZZHKC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj. GVJ u njoh me rezultatet e disa vetëvlerësimeve dhe masat që janë marrë për të adresuar disa prej çështjeve që kanë lindur gjatë këtij procesi.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Këto politika paraqiten në mënyrë shteruese në Dokumentin e Politikës së Vlerësimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Dokumentacioni i politikës së vlerësimit
- Formular i vlerësimit të studentëve për pedagogun dhe lëndën
- Raporte të vlerësimit të brendshëm
- Raporte të vlerësimit të studentëve

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"><li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li><li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li><li>c. Pyetje konceptuale;</li><li>d. Intervista;</li><li>e. Etj.</li></ol>	<p>Bazuar në RVJ dhe në vizitën në institucion, rezultojnë se institucioni përdor një sërë instrumentesh matëse dhe vlerësuese: formular për vlerëvimin e lëndës dhe të pedagogut për studentët; raporte të vlerësimit të studentëve; raporte vetë-vlerësimi për Senatin; raporte vetë-vlerësimi për Rektorin.</p> <p>Këto raporte vetëvlerësimi shërbejnë për të përmirësuar programet.</p> <p>Institucioni i publikon rregullisht rezultatet e vlerësimit dhe objektivat e cilësisë në faqen zyrtare të internetit (<a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a>), në një rubrikë të veçantë (Dossier/Cilësia Akademike/Vlerësimi i Performancës). Institucioni ka publikuar në mënyrë transparente dokumentin e politikës së vlerësimit. Institucioni gjithashtu rezultojnë se ka përgatitur dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ndjek procedurën e caktuar për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar një ndërthurje metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e</p>

<p><b>Të drejtpërdrejta:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>vlerësimi, të brendshëm, me mekanizma të shumëfishtë vlerësimi për studentët, universitetin, intervista, dhe monitorim të mësimdhënies në auditor.</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, shqyrtimi i RVB-së dhe vizita në institucion, rezulton se institucioni publikon rregullisht të dhënat dhe rezultatet e vlerësimit të brendshëm, shoqëruar me raportet dhe informacionin përkatës.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, shqyrtimi i RVB-së dhe vizita në institucion, rezulton se institucioni ka hartuar një analizë vjetore të ecurisë së programeve të studimit të Masterit Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik. Kjo analizë i është vënë në dispozicion të gjitha grupeve të interesit brenda institucionit. Dokumenti që përdor institucioni quhet Dokumenti i Politikës së Vlerësimit dhe konsiderohet se i plotëson të gjitha nevojat lidhur me hartimin e politikave dhe përmirësimin e programeve.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji</p>	<p>UMB është akredituar në nivel institucional për herë të parë në vitin 2009 me Urdhër Nr. 288 (04/09/2009) të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit. Më pas ai është riakredituar në nivel institucional me vendimin e Bordit të Akreditimit VBA Nr. 9 7/04/2017, deri në datën 06/04/2023.</p> <p>Institucioni ka përdorur një sërë mekanizmesh formalë, jo vetëm cilësorë por edhe sasiorë, përfshirë monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin e studentëve për çdo lëndë, feedback-un nga pedagogët dhe studentët për çdo lëndë, pyetësorë, rezultatet e proimeve, vëzhgime të praktikës, etj.</p> <p>Është verifikuar se të gjitha këto procedura janë pasqyruar në raportin e vlerësimit të brendshëm.</p>

për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Institucioni përdor mekanizmat e duhur formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit në shqyrtim.

Institucioni i bën me dije studentëve dhe palëve të tjera rezultatet e procesit të vlerësimit dhe të garantimit të cilësisë.

Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë.

**POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

**7. Programi i studimit, organizimi i tij**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Bazuar në RVB dhe në dokumentet e tjera mbështetëse, konstatohet se ky program studimi bazohet në nevojën që ka lindur prej zhvillimit të vullshëm të sektorit publik dhe kërkesës për një gjeneratë të re punonjësisht të administratës publike me njohuri të thella në këtë drejtim. Programi synon jo vetëm njohjen e funksionimit të parimeve të administratës publike, por edhe aftësimin praktik mbi metodat e reja të menaxhimit. Ky program është bazuar gjithashtu në studimin e nevojave të tregut për një sasi të konsiderueshme individësh me njohuri të avancuara rreth administratës publike. Sa u takon objektivave të programit, ai synon të jetë në një hap me zhvillimet bashkëkohore dhe tendencat që vërehen në sistemet administrative. Të përhapë konceptet moderne të menaxhimit publik dhe informatizimin e sektorit publik. Programi i studimeve, u ofron studentëve dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme për një punë të thelluar kërkimore, autonome, e cila do të bëhet bazë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të ndërlikuara administrative. Qëllimi dhe objektivat e programit janë ofruar në mënyrë të qartë. Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik është ndërtuar mbi programin bachelor në Shkenca Politike dhe është konceptuar si vazhdimësi dhe thellim i njohurive të fituar në ciklin e parë të studimeve.

Organizimi i programit është bërë në një vit akademike ose 30 javë mësimi në auditor, ose 15 javë për çdo semestër. Vetë programi është i organizuar në bazë të krediteve ECTS sipas procesit të Bolonjës, për një total prej 60 ECTS, nga të cilat 42 ECTS përfitohen gjatë lëndëve të përfundimit të lëndëve të parashikuara në planin mësimor dhe 18 ECTS për praktikën dhe Provën Finale. Edhe ndarja e orëve dhe e lëndëve është organizuar në bazë të sistemit ECTS duke harmonizuar si punën e studentëve në auditor (leksione frontale, punë në grupe apo prezantime) ashtu edhe punën e pavarur në përgjithësi. 1 ECTS është e barabartë me 25 orë pune të studentit, ndërsa ora mësimore është 60 minuta.

Literatura në dispozicion të studentëve është një ndërthurje midis asaj shqiptare dhe në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht). Ajo vihet në dispozicion nëpërmjet bibliotekës dhe librarisë së universitetit. Disa prej lëndëve, që lidhen ngushtësisht me Shqipërinë, e kanë literaturën të fokusuar në rastin shqiptar, ndërsa ka lëndë të tjera, si "E-Qeverisja në hapësirën administrative", të cilat për shkak të natyrës së tyre e kanë literaturën të përgatitur nga lektori i lëndës.

**Megjithatë vihet re se nuk ekzistojnë në program lëndë me zgjedhje, i cili ka qënë edhe një prej rekomandimeve të akreditimit të mëparshëm.**

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Ky program i Masterit Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik funksionon që prej vitit akademik 2012-2013. Programi është i organizuar në një vit studimi, dy semetra, 15 javë secili prej tyre. Ndër

objektivat e identifikuar për këtë program studimi janë: i) njohuritë e specializuara dhe bashkëkohore në administrimin publik dhe integrimin evropian; ii) aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve dhe kërkimin e aplikuar; iii) zhvillimi i kompetencave të përgjithshme e të transferueshme.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
  - 1 ECTS 25 orë pune të studentit
  - 1 orë mësimore 60 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë. Plani mësimor i këtij programi është ndarë në dy semestra brenda një viti akademik me nga 25 ECTS dhe 35 ECTS respektivisht për semestrin e parë dhe të dytë, për një total prej 60 ECTS. Ngarkesa e çdo lënde është shprehur në numrin e orëve dhe vlerën respektive në ECTS. Organizimi i lëndëve të ofruara është bërë në bazë të raportit orë mësimi ECTS. Orët e mësimit janë të ndara në auditor, seminare dhe punë e pavarur e studentëve (ndërkohë që këtu llogariten edhe orët e praktikës profesionale dhe të provës finale). Në periudhën e marrë në shqyrtim programi nuk ka pësuar ndryshime Në përgjithësi, në të dy semestrat e marrë në shqyrtim ka një shpërndarje orësh që favorizon punën e pavarur të studentit në krahasim me orët në auditor. Mënyra kryesore e vlerësimit të studentëve është provimi, ndonëse në disa prej moduleve parashihen edhe mënyra të tjera integruese siç janë prezantimet apo puna në grup si pjesë e vlerësimit përfundimtar. Plani mësimor i detajuar jepet në Tabelën në Aneks.

**(Shih në Aneks, Tabelën)**

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
- |                              |                           |                                    |
|------------------------------|---------------------------|------------------------------------|
| ▪ Për leksionet              | 10 orë në auditor dhe     | 15 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Seminaret              | 10 orë në auditor dhe     | 15 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 80 orë në institucion dhe | 70 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Prova Finale               | 100 orë në auditor dhe    | 200 orë punë e pavarur e studentit |

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara  
**(Nuk ka.)**

Megjithatë, sikurse kemi konstatuar dhe në pjesë të tjera të këtij raporti, ndonëse gjatë këtyre viteve të funksionimit, programi nuk ka pasur ndryshime, vërehet një nevojë për shtimin e lëndëve me zgjedhje, të cilat mungojnë. **Ky ndryshim i sugjeruar përputhet me sugjerimin për lëndë me zgjedhje.**

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

**(Shih në Aneks, Tabelën.)**

Siç rezulton nga ballafaqimi i lëndëve me të dhënat e depozituara për karrierën akademike dhe CV-në e personelit akademik, në përgjithësi lëndët përputhen me formimin akademik të secilit anëtar. Kjo vlen jo vetëm për lëndët e karakterit të profilit dhe që burojnë nga departamenti (me pedagogë si PhD. D. J. që mbulon Administrimin Publik dhe Integrimin Evropian), por edhe për lëndët që mbulohen nga departamente të tjera, si Financat Publike (me pedagog E. M). Ajo që konstatojmë ne si GVB është se stafi akademik i angazhaur në këtë program studimi ka një karrierë dhe përvojë të gjatë akademike në fushat specifike që mbulon.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.
- Emërtimi i lëndës/modulit
  - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
  - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
  - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
  - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
  - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
  - Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
  - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
  - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
  - Format e vlerësimit të studentëve

- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

RVB dhe informacioni i paraqitur nga Institucioni, përmban në përgjithësi të gjitha informacionet e kërkuara në pikat e mësipërme, duke respektuar emërtimet e lëndëve dhe tematikave të trajtuara. Paraqiten qartë vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ndërsa në disa raste anashkalohen, për shkak të natyrës së lëndëve, (si psh. në rastin e Financave Publike dhe E-Qeverisjes në Hapësirën Administrative) informacione rreth njohurive paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin sa më të mirë të lëndës.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Në tërësi, silabuset janë të standardizuara dhe ofrojnë një panoramë të qartë të llojit të lëndëve, tipologjisë që u përkasin, kreditet, informacion për të kontaktuar pedagogun, një përmbledhje të shkurtër të lëndës, të vlefshme për të kuptuar në terma të përgjithshëm njohuritë që fitohen gjatë një semestri, konceptet themelore çelës, si dhe temat. Lëndët janë ndarë sipas kategorive. Ato janë ndarë në Lëndë bazë (kategoria A), Lëndë karakterizuese më pranë profilit të programit (Kategoria B), lëndë interdisiplinore dhe lëndë plotësuese. Ky klasifikim përmbush diapazonin e njohurive të nevojshme për studentët e diplomuar në këtë nivel.

Ndërsa literatura është e integruar sipas çdo teme dhe në përfundim të silabusit, duke e diferencuar literaturën e detyruar prej asaj të rekomanduar. Literatura është e përditësuar në shumicën e lëndëve me literaturë bashkëkohore dhe të vlefshme për këtë profil studimesh. Së fundi, silabuset përmbajnë të shprehur qartë dhe formën e kontrollit të dijeve, duke e klasifikuar atë përgjithësisht (por jo ekskluzivisht) në tre kategori: projekt kursi, pjesëmarrja në diskutime, provimi përfundimtar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Sa i takon programit të Masterit Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik që po merret në shqyrtim, ai i është nënshtruar procedurës së vlerësimit dhe akreditimit paraprak. Ky program rezulton i licencuar me VKM Nr. 96 (27.01.2009) “Për hapjen programeve të studimit të ciklit të dytë në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”. Ai i është nënshtruar procedurës së vlerësimit ku është akredituar me Urdhër MASH Nr. 329 datë 07.08.2012 për një periudhë 6 vjeçare (2012-08-07 deri në 2018-08-07) si “Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik”. Programi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), të cilat janë shpërndarë në përputhje me kriteret ligjore.</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara nga studentët në total është 60 ECTS, përgjatë një viti akademik, e shpërndarë në dy semestra me 25 dhe 35 ECTS përkatësisht.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të</p>	<p>Programi i marrë në shqyrtim vlerësohet se i pajis studentët me njohuri teorike dhe shkathtësi praktike duke lidhur kërkimin shkencor me profesionin. Nga analiza e silabuseve dhe e lëndëve që ofron, ky program ofron njohuri më të thelluara se programi i Bachelorit. Siç rezultoi dhe nga takimi i organizuar me stafin akademik dhe studentët (29/10/2018), organizimi i lëndëve dhe mënyra e vlerësimit, përgatitja e prezantimeve dhe aktiviteteve të tjera gjatë lëndëve, gërshetuar me organizimin e praktikave dhe aktiviteteve të tjera, përmbushin kriteret për formësimin e kompetencave të përgjithshme dhe atyre profesionale të studentëve.</p>



<p>ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Tematika e lëndëve dhe përmbajtja e tyre në shumicën e rasteve është një hap cilësor më tej përsa i takon njohurive të fituara gjatë programit bachelor.</p> <p><i>* Sa i takon Kriterit 6, ai nuk mund të aplikohet për këtë program studimi.</i></p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Në strategjinë e programit është paraqitur në mënyrë të qartë lidhja midis çdo objektivi të programit, kurrikulës dhe synimit përfundimtar të programit. Materiali që ofrohet nga ana akademike përmban një nivel të kënaqshëm të njohurive. Kriteri përmbushet nga ana e tematikave studimore dhe sa i takon mënyrës së renditjes së objektivave.</p> <p>Metodat e ndryshme të vlerësimit që aplikohen në program, shpërndarja dhe frekuenca e tyre, si dhe harmonizimi i elementëve të ndryshëm në vlerësimin përfundimtar dëshmojnë në mënyrë të saktë njohuritë e fituara nga studentët gjatë vitit.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve evropiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimin në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjisllacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Informacioni i ofruar si nga RVB por edhe nga dokumentacioni i paraqitur lidhur me bashkëpunimin me institucionet akademike ndërkombëtare ofron një pasqyrë të qartë në këtë drejtim. Programi mësimor është përgjithësisht aktual në krahasim me vendet e tjera.</p> <p>Informacioni lidhur me vlerën ndërkombëtare të programit të paraqitur nuk është i thelluar, ndërsa mungojnë referencat e drejtpërdrejta mbi programet ndërkombëtare të shfrytëzuara për ndërtimin e masterit, ndonëse në RVB përmendet fakti se janë marrë parasysht disa eksperiencia ndërkombëtare (fq. 57).</p> <p>Pranimi i studentëve në program është parashtruar tek rregullorja e programit të studimit. Kreditet, kriteret e vlerësimit apo të tjerë komponentë janë në përputhje me praktikën evropiane.</p> <p>Lidhur me faktin nëse programi i studimeve është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjisllacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, informacioni i paraqitur ofron të dhëna</p>

	(ndonëse jo të thelluara) me këtë aspekt. Megjithatë, informacionet e ofruara në të tjera seksione të vlerësimit dhe dokumentat e bashkëngjitura tregojnë se lidhur me aspektet formale, programi është hartuar në përgjithësi në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së.
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i Masterit Profesional për Shkenca Politike me profil Administrim Publik synon pajisjen e studentëve me aftësi profesionale dhe të kërkimit në fushën e administrimi publik. Praktika lidhet me dy komponentë kyçë: praktikën profesionale dhe mbështetjen nëpërmjet rrjetit të krijuar dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse të universitetit. Kërkimi shkencor realizohet nëpërmjet lëndës së metodave të kërkimit, pa lënë mënjanë as elementet e kërkimit në lëndët e tjera.</p> <p>Ky programi studimi dhe format e aplikimit gjatë ushtrimit të tij mundësojnë aftësimin e studentëve. Raporti dhe dokumentet mbështetëse ofrojnë informacion të mjaftueshëm për aftësimin profesional të studentëve sidomos lidhur me praktikat mësimore.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me ligjet dhe dispozitat në fuqi të Ministrisë së Arsimit.</p> <p>PAE dhe PAK janë angazhuar pranë këtij programi në punime kërkimore dhe shkencore, të lidhura sidomos me projektet e institucionit.</p> <p>Argumentimi i mësipërm vlen edhe përse i takon punës kërkimore të zhvilluar nga personeli i angazhuar në programin e studimeve në përputhje me objektivat dhe synimet akademike të programit.</p>
<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Ky program masteri profesional është në përputhje me nevojat e tregut të punës, pasi për të është hartuar një studim i tregut të punës, për të identifikuar nevojat, potencialin, hendeqet, etj. Në këtë mënyrë, ky program tenton të plotësojë nevojat e administratës publike dhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë që lidhen me të.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin mbështetës SHLUJ UMB ka ndërmarrë një analizë të kërkesave të tregut të punës për administratën publike. Aty identifikohen nevojat e paraqitura nga institucionet qëndrore, kërkesat e punëdhënësve dhe mundësitë e tregut.</p> <p>Megjithatë nuk ekziston ndonjë parashikim i saktë i numrit të pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program, kjo edhe për shkak të fluiditetit të tregut të arsimit të lartë dhe atij të Masterit profesional në veçanti.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Duke u bazuar në lëndët e ofruara, në silabuset e tyre dhe në literaturën që i shoqëron ato, ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ai mund të kontribuojë në krijimin e vlerave të një administrate publike moderne, në kuadrin e një shoqërie të hapur e demokratike.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p><i>*Nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi quhet i përfunduar pasi një student arrin të grumbullojë, bazuar në rregulloren e institucionit 60 kredite, ECTS. Plani mësimor i këtij programi ka 42 kredite për pjesën teorike nga të cilat 5 kredite për lëndët bazë, 23 për lëndët karakterizuese, 14 kredite për lëndët ndërdisiplinore, 6 kredite për praktikën dhe 12 kredite për provën finale. Kohëzgjatja normale e këtij programi është 1 (një) vit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p><i>*Nuk aplikohet për këtë program studimi.</i></p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Institucioni ka garantuar përhapjen e informacionit për programet e studimeve nëpërmjet një tërësie mekanizmesh, si faqes së tij të internetit, mediave sociale (Facebook), medias së shtypur (gazetave) dhe formave të tjera.</p>
<p><b>Standardi II.8 – Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Programi përmban një plan diplomimi në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar, sepse përmban shpërndarjen e krediteve sipas dy semestrave si dhe kriteret që duhet të plotësojë çdo student që ndjek këtë Master Profesional për t'u diplomuar.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Programi vlerësohet se i pajis studentët me njohuri teorike dhe shkathtësi praktike duke lidhur kërkimin shkencor me profesionin.</p> <p>Programi është në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Metodat e ndryshme të vlerësimit që aplikohen në program, shpërndarja dhe frekuenca e tyre, si dhe harmonizimi i elementëve të ndryshëm në vlerësimin përfundimtar dëshmojnë në mënyrë të saktë njohuritë e fituara nga studentët gjatë vitit.</p> <p>Silabuset janë në përputhje me standardet e kërkuara dhe të harmonizuara në funksion të njohurive me të cilat</p>	

programi synon të formojë studentët.

Literatura është e përditësuar dhe e një niveli të kënaqshëm.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në programin e studimit Master Profesional në Shkenca politike me profil Administrim Publik vihet re se mësimdhënia bazohet në një kurrikulë me lëndë të veçanta, të miratuara që në hapjen e programit. Nuk konstatohen ndryshime të tjera në lëndë pas miratimit të kësaj kurrikule dhe për periudhën që merr në shqyrtim ky proces ri-akreditimi. Konstatohet se mësimdhënia ndahet përgjithësisht në dy kategori, në varësi dhe të llojit të lëndës: leksione dhe seminare. Ajo organizohet duke kombinuar disa forma. Forma bazë është ajo e kombinimit të leksioneve, seminareve, prezantimeve të projekteve të studenteve, etj. Leksionet zhvillohen me ndihmën e mjeteve didaktike elektronike (si Projektorët). Seminaret janë interaktive (të pasura me debate, teste, ushtrime praktike e profesionale). Interaktiviteti realizohet nëpërmjet rasteve studimore, ndarjes së punës në grup, prezantimeve të çështjeve specifike, etj. Vlerësimi ndahet në disa komponentë, megjithatë përqindjet variojnë sipas lëndëve dhe kriterëve që përdoren. Vërehet gjithashtu se studentët bëhen pjesë e projekteve të Fakultetit apo qendrave kërkimore të institucionit, në varësi të mundësisë. Studentët mund të vlerësojnë përmes vlerësimit të çdo lënde. Forma të tjera vlerësimi përfshijnë "kontrollin në auditor". Një konstatim tjetër lidhet me mungesën e lëndëve opsionale. Shpjegimi i GVB ishte se kjo çështje është diskutuar por ka qenë Rektori që ka vendosur të mos e ndryshojë situatën. Nuk është verifikuar një sistem i brendshëm anti-plagjiaturë, ndonëse kjo mund të realizohet me metoda të jashtme nga PAE dhe PAK, në mënyrë që studentët të shmangin plagjiaturat.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

### Shih Tabelën në Aneks

Format e kontrollit të njohurive

Forma e kontrollit të njohurive për lëndët e programit në shqyrtim përfshijnë disa komponentë: testin e ndërmjetëm (20%); projektin e kursit ose analizën e një rasti studimor (15%); pjesëmarrja në diskutime në seminar (15%); dhe provimin përfundimtar (50%). Nga konstatimi gjatë vizitës rezulton se kjo nuk është forma e vetme e vlerësimit të lëndëve, pasi disa lëndë kanë natyrë më praktike.

### Shih Tabelën në Aneks

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Rezultoni se aktivizimi i studentëve në kërkimet shkencore dhe projektet e implementuara nga departamenti dhe institucioni në tërësi ka qenë i kënaqshëm. Numri i studentëve të aktivizuar ka qenë rreth 24, të cilat përfshijnë

punë kërkimore individuale të pedagogëve të departamentit, projekte shkencore në nivel departamenti ose në nivel fakulteti. Pranë institucionit funksionojnë disa njësi të tjera ndihmëse (në formë OJF), si Youth Act, Adiapolli dhe AIPA, të cilat zhvillojnë projekte të natyrave të ndryshme, të financuara nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Institucioni ka një politikë të pranimit të studentëve për këtë program studimi Masteri Profesional. Ai ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, ka detajuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe i ka harmonizuar këto me kuadrin ligjor kombëtar mbi arsimin universitar. Cilësia mesatare e studentëve në hyrje në këtë program ka qenë rreth 7.2, ndërsa në dalje ajo rritet në rreth 8.55. Në total numri i studentëve të regjistruar ka qenë 88, ndërsa i të diplomuarve 55 (pa përfshirë vitin aktual akademik 2017-2018). Institucioni i ka kushtuar një vend të posaçëm qasjes në treg të të diplomuarve vetëm vitet e fundit, ndërsa është ngritur edhe struktura e Alumni për të krijuar një rrjet të diplomuarish.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Institucioni ka ndërtuar një numër kriteresh dhe procedurash standarde të pranimit, të artikuluar në rregulloren e studimeve, mes të cilave: i) zotërimin e një diplome universitare “Bachelor” ose diplomë tjetër studimi të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të në fushën përkatëse ose në fusha të përafërta me programin për të cilin aplikon. Në rastin kur diploma nuk përputhet me fushën e programit të kërkuar, departamenti që mbulon programin përkatës të studimeve master vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja në fushë janë të mjaftueshme apo përcakton nëse kandidati duhet të realizojë një program përafërimi. ii) notë mesatare të studimeve universitare “Bachelor” 6.00 ose më e madhe. iii) të arrijë rezultate të mira në çdo testim pranimi ose intervistë të kërkuar nga departamenti. iv) Të shprehë qartë qëllimin e ndjekjes së studimeve në programin Master Profesional; v) Të rekomandohet nga dy persona të cilët i njohin aftësitë akademike, profesionale, kërkimore dhe personale të kandidatit; vi) të provojë se është në gjendje të plotësojë nevojat financiare të studimit. Institucioni, bazuar dhe në kriteret e Bolonjës, mund të pranojë transferimin e studentëve në të njëjtin nivel studimor nga universitete të tjera vendase ose të huaja, sipas procedurave dhe dispozitave në fuqi.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Konstatohet se cilësia në hyrje dhe në dalje pëson një luhajtje të konsiderueshme gjatë tre viteve të para të funksionimit të programit (nga 6.7 në hyrje në vitin akademik 2012-2013, në 9.2 në dalje në po të njëjtin vit – e njëjta situatë përsëritet përafërsisht edhe për vitet pasardhëse 2013-2014 dhe 2014-2015, ndërsa arrin deri-diku një balancim në vitet 2015-2016 dhe 2016-2017).

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare:

Gjatë vitit akademik 2017-2018, studentët e regjistruar për herë të parë janë 8. Nota e tyre mesatare në hyrje është 7.00.

### Shih Tabelën në Aneks

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Viti i fundit i studentëve të diplomuar ishte viti 2016-2017, me 10 studentë të diplomuar (pa vite përsëritëse) dhe me notë mesatare 8.3.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim ka patur një mobilitet më të lartë në vitet 2014-2015 dhe 2015-2016, i cili ka ardhur pjesërisht për shkak të procesit të mbylljes së një numri institucionesh të tjera të arsimit të lartë.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Sa i takon punësimin të studentëve, konstatohet se numri i total i të punësuarve në përputhje me diplomën ka qenë në raportet (të diplomuar-të punësuar): 6/2; 6/3; 14/6; 19/4 dhe 10/4. Kjo tregon se vetëm një numër relativisht i vogël të diplomuarish punësohen në një profil të ngjashëm me atë të studimeve të tyre. Kjo mund të nxjerrë gjithashtu në pah një nevojë për studim më të plotë tregu.

Numri total të diplomuarve

Numri total i të diplomuarve që prej fillimit të funksionimit të këtij programi (pra prej vitit akademik 2011-2012) është 88.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të diplomuarve, të punësuar në përputhje me profilin e diplomës është 19.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i të diplomuarve, të punësuar jo në përputhje me profilin e diplomës është 17.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS; <b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi; <b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni; <b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve; <b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program Masteri zotërojnë minimalisht diplomën Bachelor (dhe kanë siguruar të paktën 180 ECTS), prandaj ky kriter përmbushet plotësisht. Konstatohet se të gjithë studentët janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore. Rezulton se kriteret e regjistrimit që aplikon institucioni janë ato ligjore, të cilave u shtohet dhe mesatarja (6.0) si kriter shtesë. Këto kriteret dhe standarde respektohen plotësisht. Gjithashtu u konstatuan edhe kriteret e tjera të përzgjedhjes, si komisioni i ngritur nga fakulteti, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe dosjet personale të kandidatëve për këtë program.
<b>Standardi IV.2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimin.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Konstatohet nga RVB dhe vizita në institucion se Institucioni ka ngritur një zyrë që jep informacion për mundësitë e punësimit dhe ofron shërbimin e këshillimit. Kjo zyrë emërtohet Zyra e Alumnit dhe Karrierës (ZAK) dhe ka si detyrë të ofrojë sa më shumë mundësi punësimi për studentët, duke bërë lidhjen e tyre me tregun e punës.</p> <p>Nga ana tjetër, ZZHKC është një strukturë tjetër që informon studentët për proceset e akreditimit të institucionit, programet e studimit, konsultohet me ta për mundësitë e zhvillimit të kurrikulave, etj.</p> <p>Gjithashtu konstatohet ZAK u ofron studentëve këshillime karriere, sidomos në nivelin e zhvillimit të praktikës profesionale.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentet mbështetëse, konstatohet se institucioni mban statistika të plota vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Kështu në total, që prej fillimit të këtij programi (2012-2018) janë regjistruar në total 88 studentë, nga të cilët janë diplomuar 55. Për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 8 studentë, ndonëse prej tyre nuk ka asnjë të diplomuar.</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur një bazë të dhënash për punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Kjo databazë është e përditësuar, vit pas viti.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Konstatohet nga RVB dhe vizita në institucion (pranë sekretarisë mësimore) se studentët informohen në mënyrë konstante për gjithçka lidhet me studimet e tyre (programin, organizimin, akreditimin, etj.).</p> <p>Konstatohet informimi transparent dhe i vazhdueshëm lidhur me vlerësimin.</p> <p>Vlerësimet e programit diskutohen në mënyrë transparente me studentët, të cilëve u merret mendimi për të përmirësuar aty ku ka vend.</p> <p>Ky standard plotësohet.</p>
<p><b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni u siguron studentëve këshillim të vazhdueshëm përmes Zyrës së Alumni dhe Karrierës. Ai u garanton studentëve mundësi të zhvillimit të praktikave dhe zgjedhjen e institucioneve.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Konstatohet se institucioni ka përmbushur detyrimet për të krijuar një bazë të dhënash për këtë program studimi lidhur me punësimin e studentëve.</p> <p>Konstatohet se institucioni ka përmbushur detyrimet për të ngritur Zyrën e Alumni dhe Karrierës për studentëve në mbështetje të tyre gjatë dhe pas studimeve. Kjo tregon se institucioni i ka kushtuar rëndësi të veçantë informimit të studentëve për programet, karrierën dhe tregun e punës.</p> <p>Konstatohet se institucioni disponon statistika vjetore dhe periodike të numrit të të regjistruarve dhe të të diplomuarve.</p> <p>Konstatohet se të gjithë studentët janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore.</p> <p>Konstatohet se institucioni ka garantuar transparencën e vlerësimeve të studentëve.</p>	

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Institucioni ka ngritur ndër vite disa struktura të kërkimit shkencor, funksionimi dhe organizimi i të cilave përcaktohet nga politikat institucionale dhe mbështetet në rregullore, statut dhe aktet e tjera rregullatore. SHLUJ UMB ndjek politika specifike dhe bashkëpunon për kërkimin shkencor me faktorë të jashtëm e të brendshëm në mënyrë të institucionalizuar me marrëveshje ose në mënyrë individuale e në grup midis stafit akademik dhe institucioneve të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Pranë institucionit funksionon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit “Barleti”, Instituti Shqiptar për Çështje Publike dhe Instituti i Edukimit Barleti. Institutet janë qendra të zhvillimit të kërkimeve, trajnimeve, konsulencave, botimeve dhe projekteve. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, u konstatua se institutet kanë bashkëpunuar me rrjete evropiane e ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit.

Institucioni ka një strategji kërkimore të qartë e cila përfshin: i) partneritetin dhe integrimin e të rinjve në kërkimin shkencor; ii) kërkimin në politikat mjedisore, sociale dhe ekonomike; iii) partneritet me komunitetin e biznesit; iv) inovacion në metodat e mësimdhënies. Një pjesë e punës kërkimore të institucionit pasqyrohet në përmirësimin e kurrikulave të mësimdhënies. Staf i angazhohet në aktivitete brenda dhe jashtë vendit, të organizuara nga njësia kërkimore ose në bashkëpunim me institucione të tjera shkencore. Gjithashtu edhe studentët janë përfshirë në punë kërkimore shkencore. aktivitete shkencore.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Pranë Institucionit funksionon revista shkencore Gjeopolitika për botimet shkencore të stafit akademik, ndërsa janë akredituar nga institucione ndërkombëtare i dy katedrave, Katedra Jean Monnet dhe ajo e UNESCO-s, të cilat janë afiluar pranë Departamentit të Shkencave Politike, dhe kanë edhe lidhje të drejtpërdrejta me programin e studimit.

PAE kanë botuar 2 tekste mësimore, 2 monografi dhe 82 artikuj shkencorë. Ndërkohë numri i projekteve të fituara është 17, 11 prej të cilëve janë projekte të zbatuara; kurse janë zhvilluar 19.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takimet në institucion (sidomos takimi me PAE dhe PAK), konstatohet se personeli akademik ka publikuar një numër të konsiderueshëm artikujsh dhe materialesh shkencore.</p> <p>Nëpërmjet projekteve të BE-së, si Jean Monnet, personeli akademik jep kontributin e tij në zhvillimin e shkencës, e konkretisht në forcimin e njohurive të administratës publike rreth institucioneve dhe politikave të BE-së.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Konstatohet se një lëndë i përket katedrës Jean Monnet dhe është e akredituar nga Bashkimi Evropian (lënda Adminsitrim publik dhe Integrim Evropian me 6 ECTS). Megjithëse lënda zhvillohet në gjuhën shqip, stafi ka kualifikimet e huaja dhe përvojën e nevojshme për ta ofruar atë edhe në gjuhën angleze.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për kualifikimin profesional të personelit akademik, të cilat janë: i) revista shkencore "Gjeopolitika"; ii) konferencat e zhvilluara në institucion ose brenda vendit në institucione të tjera shkencore; iii) konferenca ndërkombëtare; iv) pjesëmarrje në projekte shkencore ndërkombëtare; v) nëpërmjet kërkimit shkencor në institutet e afiluara pranë institucionit. Pjesëmarrja jashtë vendit për veprimtari shkencore mbështetet financiarisht vetëm sporadikisht nga institucioni, përveç rasteve kur ato mbështeten paraprakisht nga projektet kërkimore-shkencore ku institucioni bën pjesë. Gjithashtu konstatohet se mungojnë trajnimet periodike (të rregullta) të stafit, por këto realizohen si aktivitete brenda departamentit, ndërsa trajnimet zhvillohen në mënyrë <i>ad hoc</i>, sipas tematikave specifike.</p> <p>Institucioni nuk ka një buxhet të dedikuar për mbështetjen e kërkimit shkencor, ndërsa ndodhet në procesin e nxjerrjes së një Urdhri të Administratorit lidhur me rregullimin e formave të mbështetjes financiare të kërkimit shkencor.</p>
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion një bazë të plotë të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik në përgjithësi dhe ofron të dhëna për programin specifik të studimit që po ri-akreditohet.</p> <p>Konstatohet se në bibliotekë ndodhej një</p>

<p>konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>databazë literature e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku përfshiheshin edhe kontributet shkencore/botimet e pedagogëve të departamentit.</p> <p>Konstatohet se personeli akademik është përfshirë individualisht dhe në grup në projekte kërkimore-shkencore.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për kualifikimin profesional të personelit akademik</p> <p>Konstatohet se personeli akademik ka publikuar një numër të konsiderueshëm artikujsh dhe materialesh shkencore.</p> <p>Stafi angazhohet në aktivitete brenda dhe jashtë vendit, të organizuara nga njësia kërkimore ose në bashkëpunim me institucione të tjera shkencore.</p> <p>Konstatohet se studentët janë përfshirë në veprimtaritë kërkimore-shkencore të njësisë bazë (Departamentit) dhe të stafit akademik PAE &amp; PAK.</p> <p><b>Rekomandime:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rekomandohen trajnime të rregullta/periodike të zhvillimit profesional të stafit akademik.</li> </ol>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Konstatohet se Institucioni ka zhvilluar një sërë bashkëpunimesh me institucione të tjera në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në nivel lokal ka zhvilluar bashkëpunime me bashkitë për vlerësimet e kapaciteteve dhe nevojave, ndërsa në nivel kombëtar me një rrjet të dendur institucionesh, përfshirë dhe institucione akademike. Ndër institucionet radhiten: ministritë, bankat, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe korporatat e mëdha, Akademia e Shkencave, gjimnazet, universitetet e tjerë, studiot ligjore, unionin e gjyqtarëve, etj. Në nivel ndërkombëtar Institucioni ka zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi shkencor me institucione nga Kosova, Maqedonia, SHBA, Italia, Mbretëria e Bashkuar, etj. Këto marrëveshje kanë kontribuar ndjeshëm në krijimin e rrjeteve të gjera për tregun e punës.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Shumica e marrëveshjeve të bashkëpunimit të paraqitura në dokumentacionin bashkëngjitur raportit lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me programin e paraqitur për akreditim, siç janë marrëveshjet me bashkitë, me disa kompani apo institucione të cilat i shërbejnë dukshëm programit të Institucionit që po shqyrtohet. Marrëveshjet me shumicën e universiteteve ndërkombëtare janë marrëveshje kuadër. Megjithatë, fushat e bashkëpunimit të paraqitura nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion, mbulojnë të gjitha fushat në të cilat operon Institucioni, jo vetëm ato të programit specifik.

### Shih Tabelën në Aneks




## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni ka një numër marrëveshesh, të cilat përfshijnë edhe kryerjen e praktikave. Megjithatë nga vizita në institucion rezulton se një numër i konsiderueshëm praktikash të këtij programi masteri kryhen pranë institucioneve në të cilat punojnë studentët – të cilat lidhen me profilin e studimeve të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Këto marrëveshje janë nga sektorë të ndryshëm, si industria, tregtia, gjyqësori (Unioni i Gjyqtarëve), shërbimet, bankat, institucionet lokale, etj.</p> <p><i>* Kriteri 2 nuk është i aplikueshëm për këtë program studimi.</i></p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni garanton nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe transparencës së komunikimit të mundësive të bashkëpunimit midis personelit PAE dhe PAK. Gjithashtu një formë tjetër e bashkëpunimit zhvillohet në nivel departamenti, me mbledhjet periodike dhe komunikimin e mundësive të bashkëpunimit për kërkime ndërmjet stafit.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka vendosur mjaft marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si edhe me aktorë institucionalë dhe të biznesit. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se ka patur edhe lektorë të ftuar që kanë mbajtur leksione pranë SHLUJ UMB. Megjithatë këto leksione të hapura përbëjnë vetëm një segment të bashkëpunimit i cili duhet të jetë shumëplanësh (si nga ana akademike ashtu edhe përsa i takon shkëmbimit të studentëve).</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>Institucioni ka zhvilluar një numër të madh marrëveshesh kuadër me institucione publike, akademike, kompani, korporata, aktorë juridikë, organizata të shoqërisë civile.</p> <p>Institucioni garanton nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe transparencës së komunikimit të mundësive të bashkëpunimit midis personelit PAE dhe PAK.</p>	




## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Institucioni ka punuar seriozisht për plotësimin e rekomandimeve të lena dhe madje ka avancuar në disa prej tyre. Konkretisht për rekomandimin për rritjen e numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë, në programin e studimit raporti i pedagogëve me kohë të plotë është rritur nga 55% në 88%, ku është angazhuar vetëm një pedagog me kohë të pjesshme. Përbërja e stafit akademik të brendshëm është rritur jo vetëm si numër nga ana sasiore, por edhe si cilësi dhe pedagogët në këtë program studimi kanë gradën shkencore Doktor, përveç një PAE doktorant në proces.

Megjithë rritjen e PAE, ende në semestrin e dytë të studimeve Master Profesional nuk ka të përfshira të paktën dy lëndë me zgjedhje. Edhe nëse me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", lëndët me zgjedhje nuk janë më të detyrueshme, ai hyn në fuqi për vitin akademik në vazhdim, Ky rekomandim nuk është plotësuar.

Për rekomandimin mbi rritjen e mesatares në hyrje të studentëve të regjistruar, kjo ka ardhur në rritje nga viti në vit, sikurse edhe numri i studentëve deri në vitin akademik 2015-2016, pastaj ka një tendencë rënije të numrit, ndonëse mesatarja mbetet e pacënuar. Rekomandimi është plotësuar.

Për rekomandimin e pasurimit të bibliotekës me literaturë vendase dhe të huaj, me propozime librash nga çdo pedagog i departamentit, çdo vit është akorduar një fond i veçantë për blerje librash. Sipas propozimeve të pedagogëve të departmentit të Shkencave Politike, ky fond librash që do t'i shërbejë edhe këtij programi studimi, ndonëse në fushën e administrimit publik ka botime të përditshme dhe pasurimi i një biblioteke nuk mbaron ndonjëherë. Grupi i vlerësimit gjykon se rekomandimi është plotësuar.

Rekomandimi i pasurimit të bibliotekës lidhet edhe me atë të përmirësimit dhe azhornimit të programit duke u bazuar në literaturën më bashkëkohore të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë. stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi na evidentoi sesi ata kanë modifikuar silabuset konform kërkesave të ligjit të ri të arsimit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare në kuadrin e projekteve Jean Monet, etj. Stafi akademik i departamentit konfirmoi se ka rishikuar syllabuset e lëndëve dhe literaturat e programit në masën e lejuar nga ligji, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen me praktikën dhe modelet bashkëkohore dhe objektivat strategjike të institucionit. Rekomandimi është plotësuar.

Për rekomandimin e dhënies së gjuhës së huaj të studentëve të këtij programi, që prej vitit akademik 2016-2017, në respekt të ligjit të ri të arsimit të lartë, kriteri i njohjes së gjuhës së huaj për këtë nivel studimi nuk përbën kriter përjashtues. Rekomandimi është plotësuar

Pas kësaj analize të detajuar të rekomandimeve të lena nga akreditimi i parë, konkludohet se ato janë plotësuar në shumicën e rasteve. Kështu nga gjashtë rekomandime të lena nga akreditimi i parë, institucioni ka plotësuar pesë prej tyre. Rekomandimi i papërmbyshur është ai që lidhet me përfshirjen e lëndëve me zgjedhje në programin e studimit, siç konstatohet nga RVB.

### **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

#### **1. Pika të forta:**

- a. SHLUJ UMB përfaqëson një institucion me reputacion të mirë të arsimit të lartë që lidhet me numrin e studentëve dhe programeve të studimit, të një stafi akademik cilësor dhe të mbi të gjitha të një vizioni dhe plani të zhvillimit strategjik të qartë dhe bashkëkohor.
- b. Programi i studimit është konceptuar dhe zbatuar në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili është reflektuar në Statutin e SHLUJ UMB, Rregulloren e Studimeve të Masterit, Paketa e Praktikës, Paketa e Provës Finale, Planet Mësimore, Programet e lëndëve, në menaxhimin e burimeve njerëzore, etj.

- c. Veprimtaria mësimore e SHLUJ UMB zhvillohet e orientuar nga zhvillimet e vendit ku një nga prioritetet e viteve të fundit ka qenë reforma e administratës publike e reflektuar në këtë Programi Masteri Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik. Ky program është ndërtuar në përputhje me vizionin e institucionit që t'i kontribuojë zhvillimit të vendit.
- d. Nevojat e tregut janë vlerësuar në bashkëpunim me institucionet e administratës publike me të cilat SHLUJ UMB mban lidhje dhe duke ndjekur punësimin e te diplomuarve të tij në këto vite.
- e. Programi i studimit respekton standardet akdemike duke i lidhur ato me aplikimet në fushën e shkencave politike dhe administrimit publik përmes lidhjeve dhe përvojave të stafit akademik që kanë pasur në pozita drejtuese në administratën publike.
- f. Cilësia e personelit akademik të anagzhuar në këtë program studimi është e lartë, me doktore brenda e jashtë vendit, të angazhuar me projekte si Erasmus+ që iu kanë mundësuar mobilitet të stafit akademik dhe studentëve.
- g. SHLUJ UMB ka hartuar një politikë për menaxhimin e personelit të institucionit që iu ka mundësuar mbi 85% e programit të realizohet nga staf akademik i brendshëm duke iu dhënë gjithë iniciativën në hartimin e kurrikulave, sylabuseve, bashkëpunimeve me universitetet brenda e jashtë vendit, promovimit të veprimtarive shkencore dhe të mbështetjen në finalizimin e punimeve të doktoraturave.
- h. Infrastruktura funksionale, mjediset e kendshme, lehtësisht të aksesueshme e të pajisura me internet e facilitete të mësimdhënies, kanë mbështetur realizimin me efektivitet të Programit Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik.

## 2. Pika të dobëta:

- a. Mungesa e përditësimit të planit mësimor të programit të studimit i cili ka mbetur pothuajse i pandryshuar në këto 6 vite.
- b. Mungesa e lëndëve me zgjedhje, e cila ka qënë edhe një nga rekomandimet e akreditimit të parë.
- c. Ndonëse institucioni ka rritur të ardhurat nga konsulentat dhe shërbimet, të ardhurat e studentëve kanë mbetur burimi kryesor i mbështetjes financiare të veprimtarisë mësimore e shkencore të tij, që përbën një sfidë në kushtet që pas vitit 2015 numri i studentëve ka tendencë rënieje si në gjithë universitetet e vendit.

## 3. Mundësitë:

- a. Stafit akademik i kualifikuar përbën një mundësi për suksesin e programi
- b. Reformat decentralizuese të administrimit publik krijojnë mundësi që programi të jetë kërkuar.
- c. Infrastruktura dhe mjediset rrisin shancet për një zbatim të suksesshëm.
- d. Prurjet e studentëve me mesatare mbi 6 rrisin reputacionin e programit dhe sigurojnë vazhdimësi.

## 4. Pengesat:

- a. Programe në fushën e administrimit publik ka në disa IAL dhe mbi të gjitha Shkolla e Administratës Publike që synon kualifikimin e administratës në nivel qendror e vendor.
- b. Pavarësisht punës së SHLUJ UMB për lidhjen e teorisë me praktikën e institucioneve të administratës publike në rastin e këtij programi studimi, rritja e profesionalizmit të të diplomuarve nuk nënkupton që ata mund ta kenë më të lehtë tranzicionin nga universiteti në punë në sektorin e administratës publike për shkak të politizimit të saj.

## 5. Rekomandime

- a. Rekomandohet përditësimi i planit mësimor të këtij programi nga institucioni. Ky rekomandim rezultoi nga analiza e RVB-së, nga diskutimet me stafin akademik, me drejtuesit dhe vetë studentët që ndjekin programin.
- b. Rekomandohet përfshirja e të paktën dy lëndëve me zgjedhje, në mënyrë që të krijohet mundësia për studentët që të zgjedhin lëndë opsionale. Ky rekomandim vjen në vijim edhe të rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm.
- c. Rekomandohet në planin afatgjatë ndërtimi i një sistemi të brendshëm anti-plagjiature, për esetë dhe punimet kërkimore të studentëve që frekuentojnë këtë program studimi por edhe programet e tjera.

- d. Rekomandohen trajnime të rregullta/periodike të zhvillimit profesional të stafit akademik.

### III. SWOT METHOD ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATION REPORT (STRENGTHS; WEAKNESSES; OPPORTUNITIES AND THREATS)

#### 1. Strengths:

- a. SHLUJ UMB represents a higher education institution of good reputation with regard to the number of students and the study programs, with an academic staff of high standards. It has a clear vision and development strategy.
- b. The study program is implemented in compliance with the legal framework, as reflected by the Status of the Institution, its Master Studies Regulation, the Practice Documents, the Final Exam Documentation, the Program Plans for the Curriculas, human management, etc.
- c. The learning activities of this Institution are developed and oriented in coherence with the main developmental challenges of the country, as reflected by this Professional Master Programme in Political Sciences and Public Administration. This program is built in harmony with the institutional vision of contributing in the development of the country.
- d. Market needs are evaluated and addressed in cooperation with public administration institutions.
- e. The study program respects the academic standards, applying best practices in the fields of political sciences and public administration through networking and experiences of its academic staff with previous key leadership positions within public administration.
- f. The quality of the academic personal involved in the program is high, with postgraduate and doctoral studies in Albania and abroad, engaged on Erasmus+ projects that have contributed to a remarkable mobility of academic staff and students.
- g. UMB has framed a policy for personal management that acknowledges for more than 85% of the program to be delivered by permanent academic staff.
- h. The infrastructure is functional, with easily accessible structures.

#### 2. Weaknesses:

- a. Lack of flexibility of the study program, which remained unchanged throughout these 6 years of life.
- b. Lack of electives courses, which has also been one of the first accreditation recommendations.
- c. Although the Institution has increased its income from services and consultancies for third parties, students remain the main source of financial support for its learning and scientific activities, which constitutes an important challenge, since after 2015 the number of students has shown a decreasing tendency in all Albanian universities.

#### 3. Opportunities:

- a. The qualifications of the academic staff are an opportunity for the success of this program.
- b. The decentralization reforms of the Albanian public administration provide market opportunities for this program.
- c. The modern infrastructure and auxiliary structures increase possibilities of success.
- d. Incoming students with average grade higher than 6.00 boost the program reputation and can assure its continuity.

#### 4. Threats:

- a. Master Programs on Public Administration are also found in other higher education institutions, while the Albanian School of Public Administration has been an important player in the qualification of Albanian administration at central and local level.
- b. Despite the efforts of UMB to link theory with practice in public administration institutions, the professional progress of the graduated students doesn't mean automatically a smooth transition from the university to the public sector, mainly due to its politization.

## 5. Recommendations:

- a. The External Evaluation Team recommends that the institution undertakes an update of the teaching plan for this program by the institution. This recommendation resulted by the Internal Evaluation Report, by the discussions with the academic staff, and the students enrolled in the program.
- b. The External Evaluation Team recommends the inclusion of at least two optional courses, allowing students the opportunity to choose at least one course. This recommendation follows those of the previous accreditation.
- c. The External Evaluation Team recommends in the long-term the development of an internal anti-plagiarism system, for students' essays and research papers.
- d. The External Evaluation Team recommends regular/periodical trainings for the professional development of the academic staff.

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Merita Xhumari**

**Prof. Asoc. Dr. Enri Hide**

